



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

Numri i lëndës: 2022:224201  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05755750

Pml.nr.314/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit V. P., me vendbanim në rrugën "...", nr.... në ..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.9 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarit dhe vetë i dënuari, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda P.nr.132/2023 të datës 07.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.500/2023 të datës 06.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27 maj 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me miratimin e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit dhe të dënuarit V. P., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.500/2023 të datës 06.10.2023, dhe çështja i kthehet kësaj gjykate me qëllim të dorëzimit të aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë në gjuhën e tij amtare.

**A r s y e t i m**

## **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, *me aktgjykimin* P.nr.132/2023 të datës 07.07.2023, të dënuarin V. P. e ka shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 lidhur me nenin 275 par.1, nënpar.1.9 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohen e kaluar në paraburgim nga data 28.10.2022 e tutje. Si dhe dënim me gjobë në shumën prej 3000 (tremijë) euro të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i dënuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoi me dënim me burg, ku një ditë burgimi do ti llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë. I dënuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro. Të dënuarit njëherit i ka shqiptuar dënim plotësues dhe atë i ka konfiskuar substancën narkotike të llojit marihuanë dhe tetrahidrokanabinol (THC) në peshë prej 9295.7 gram, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.500/2023 e datës 06.11.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit V. P., avokati Dejan Vasiq nga M., për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 432 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së, konkretisht aplikimit të gabuar të nenit 70 Par.3 pikat 3.3, 3.6, 3.8, 3.9 dhe 3.12 të KPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës ta ndryshojë dhe të dënuarit të i zbut dënimet e shqiptuara, ose aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë ta anulojë dhe çështjen t'ia kthen në rigjykim e rivendosje, si dhe

- i dënuari V. P., për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesë ta aprovojë si të bazuar dhe të njëjtin ta liroj nga dënimi me burg pasi që është student dhe është punësuar.

### **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.177/2024 e datës 23.05.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohen si të pabazuara.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar të dënuarit në gjuhën serbe, përkatësisht i përkthyer në gjuhën e tij amtare të cilën e flet.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pa shqyrtuar pretendimet tjera të theksuara në kërkesë del se pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit është i bazuar, ngase bazuar në pretendimin e paraqitur por edhe shkresat e lëndës del se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar në gjuhën serbe të dënuarit, me ç'rast është shkelur e drejta e tij e që rezulton të jetë shkelje e përcaktuar me dispozitën e nenit 384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 14 par. 8 të KPP-së, pretendime këto të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 14 par. 8 të KPP-së, me ç'rast është përcaktuar se: *“Të pandehurit dhe personit i cili është në vuajtje të dënimit i cili nuk e kupton gjuhën e procedurës duhet siguruar, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve*

*dhe parashtresave, në tërësi ose pjesërisht, varësisht nga fakti nëse ato janë relevante për qëllimin e mundësimit të të pandehurit ose personit që është në vuajtje të dënimit të ketë njohuri të rastit kundër tij, në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë, ose dokumenteve të tjera të cilat janë thelbësore për të siguruar që ai të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij të mbrojtjes dhe të sigurohet paanshmëria e procedurave. Dokumentet thelbësore përfshijnë çdo vendim i cili e privon personin nga liria, çdo aktakuzë dhe çdo aktgjykim.”* Andaj, nga interpretimi i dispozitës së lartë cekur dhe shkresat e lëndës del se të dënuarit aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar në gjuhën e tij amtare dhe nga kjo arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për kthimin e çështjes me qëllim dorëzimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të përkthyer në gjuhën e të dënuarit, përkatësisht në gjuhën serbe, meqë me këtë rast përveç cenimit të dispozitave të lartë cekura del se janë cënuar edhe e drejta e garantuar e përdorimit të gjuhës sipas nenit 30 par.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 par.3 nënpar.“e” të KELDNJ.

Nga këto arsye kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë pjesë u aprovua dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me vërejtje se duhet të eliminohen shkeljet e cekura dhe gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPP -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.314/2024, më 27 maj 2024

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Afrim Shala